

Në bazë të nenit 13 paragrafit 1 të Ligjit për Qendrën Shtetërore të Provimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 142/08, 148/09, 41/14, 55/16, 142/16 dhe 64/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 59/25) dhe nenit 5 paragrafi 1 i Rregullores për mënyrën, procedurën dhe kriteret për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm të Qendrës Shtetërore të Provimeve, nr. 01-440/3 të dates 28.12.2022, nr. 01-176/3 të datës 1.3.2023, nr. 01-197/3 të datës 15.04.2024, nr. 01-109/3 të datës 11.02.2025 dhe nr. 01-157/4 të datës 25.3.2025, Qendra Shtetërore e Provimeve, shpall:

KONKURS PUBLIK

për përzgjedhje të bashkëpunëtorëve të jashtëm – vlerësues të testeve të pjesës eksterne të maturës shtetërore, maturës shtetërore profesionale dhe maturës shtetërore artistike në vitin shkollor 2025/2026

I. Qendra Shtetërore e Provimeve shpall konkurs publik për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm – vlerësues të testeve nga pjesa eksterne e maturës shtetërore, maturës shtetërore profesionale dhe maturës shtetërore artistike për vitin shkollor 2025/2026, sipas lëndëve:

- 1) Gjuhë maqedonase dhe letërsi;
- 2) Gjuhë shqipe dhe letërsi;
- 3) Gjuhë turke dhe letërsi;
- 4) Gjuhë serbe dhe letërsi;
- 5) Gjuhë angleze;
- 6) Gjuhë frënge;
- 7) Gjuhë gjermane;
- 8) Gjuhë ruse;
- 9) Gjuhë italiane;
- 10) Matematikë dhe
- 11) Histori.

II. Kandidatët duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të kenë të kryer së paku studime akademike të ciklit të parë nga fusha përkatëse;
- të jenë nga radhët e mësimdhënësve të lëndës mësimore përkatëse në shkollat fillore ose të mesme në RMV dhe
- të kenë së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në mësimdhënie.

III. Kandidatët detyrimisht i dorëzojnë dokumentet në vijim:

- fletëparaqitje të plotësuar (formulari i aplikimit është i vendosur në ueb-faqen: www.dic.edu.mk);
- certifikatë shtetësie;
- kopje të certifikatës/diplomës për studime të kryera përkatëse akademike të ciklit të parë, të vërtetuar në noter dhe
- vërtetim për marrëdhënie të rregullt pune dhe përvojë përkatëse pune së paku 3 (tre) vjet si mësimdhënës në lëndën përkatëse mësimore në shkollat fillore ose të mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter.

IV. Për kandidatët që i plotësojnë kushtet e lartpërmendura, Qendra Shtetërore e Provimeve do të organizojë trajnim, më pas do të verifikohet shkathtësia dhe saktësia e kandidatëve në vlerësimin e përgjigjeve/

zgjidhjeve të nxënësve pas së cilës do të pasojë përzgjedhja përfundimtare. Kandidatët që nuk kanë marrë pjesë në trajnim, nuk do të merren parasysh në procedurën e mëtejme.

Për vlerësimin e testeve nga pjesa eksterne të maturës shtetërore, maturës shtetërore profesionale, dhe maturës shtetërore artistike, Qendra Shtetërore e Provimeve përzgjedh vlerësues nga radhët e mësimdhënësve të shkollave të mesme që realizojnë mësimdhënie sipas lëndës që vlerësohet. Me përjashtim, nëse për vlerësues nuk mund të sigurohet mësimdhënës nga shkollat e mesme, përcaktohet mësimdhënës nga shkolla fillore, me arsimim të lartë të kryer dhe që realizon mësimdhënien në lëndën që vlerësohet.

Përzgjedhja e bashkëpunëtorëve të jashtëm kryhet në mënyrë dhe procedurë të paraparë me Ligjin për Qendrën Shtetërore të Provimeve dhe Rregulloren për mënyrën, procedurën dhe kriteret për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm të Qendrës Shtetërore të Provimeve.

V. Kandidatët që do të përzgjidhen si bashkëpunëtorë të jashtëm – vlerësues të testeve nga pjesa eksterne e maturës shtetërore, maturës shtetërore profesionale dhe maturës shtetërore artistike për vitin shkollor 2025/2026, do të angazhohen deri më 15.9.2026.

VI. Afati i paraqitjes nga kandidatët e interesuar është deri më 27.2.2026.

VII. Zgjedhja e bashkëpunëtorëve të jashtëm do të përfundojë më së voni në afat prej 18 (tetëmbëdhjetë) ditësh pas përfundimit të afatit të paraqitjes.

VIII. Dokumentacioni i vonuar, i paplotë dhe i pavlefshëm nuk do të jetë lëndë shqyrtimi.

IX. Fletëparaqitje e plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm dorëzohet **VETËM NËPËRMJET POSTËS** me dërgesë të rekomanduar postare, ose me postë të shpejtë në adresën në vijim: Qendra Shtetërore e Provimeve – Shkup rr. Vasill Gjorgov p.n. 1000 Shkup, me shënimin **“Për konkursin publik për bashkëpunëtorë të jashtëm – vlerësues për lëndën ...”** (shënohet lënda për vlerësimin për të cilën po aplikojnë kandidatët).

X. Informacione shtesë për konkursin publik mund të merren në numrin e telefonit 075/258-862, çdo ditë pune nga ora 10.00 deri më ora 14.00.

QENDRA SHTETËRORE E PROVIMEVE